

Rijan Izairi, PhD.<sup>1</sup>  
Rukije Ibraimi, PhD<sup>2</sup>

UDC: 339.543(497.7)  
343.359.3(497.7)

**SHTETI**  
**(THEMELIMI, KUFIJTË, SOVRANITETI)**

**ДРЖАВА**  
**(ОСНИВАЊЕ, ГРАНИЦИ, СУВЕРЕНИТЕТ)**

**STATE**  
**(ESTABLISHMENT, BORDERS, SOVEREIGNTY)**

**Abstract**

The notion of state has a great value in political, economic, national, religious, emotional and other aspects. It is therefore no coincidence that it is said that the highest degree of civilization of people is the establishment of the state. Because, through the establishment of the state, people preserve or protect themselves, family, property, language, national, religious traditions, etc. since it protects them, people love their country or their state. Therefore, people, both in the past and now try to preserve the state and if they do not have it, they act and work to establish it, and with this they identify with themselves in the world and get acquainted with the other people of the world.

There are no ethnic countries in the world. Often, people in countries that have been established by immigrants, such as: USA, Canada, Australia are proud of their countries. But they are citizens of these

---

<sup>1</sup> Dr. sc. Rijan Izairi, Universiteti i Tetovës "Fadil Sulejmani". Email: rijan.izairi@unite.edu.mk

<sup>2</sup> Ass. Dr. Rukije Ibraimi, Universiteti i Tetovës "Fadil Sulejmani". Email: rukije.skenderi@unite.edu.mk

countries, while the local population makes up a very small percentage. This does not mean that they are a natural nation like we are in Europe. Therefore, we can freely say that they live in these countries, love it and are its citizens, speak the same (official) language. But they are people of different backgrounds, both national and racial. To distinguish a nation-state and a civic state, we will take the example of Germany, the nation-state, the white Aryan race, and to say about black or the yellow race living in Germany and having German citizenship that they are German is both absurd and ridiculous. On the other hand, regardless of race, white, black, yellow or mixed, if he/she has an American citizenship he/she is called American and is normal for anyone in the world.

It follows that people for different needs do not live in their home or national country, they love the country they live in, both national and the country in which they live. But, they identify themselves with their origin, love their people and protect it with all its features.

***Keywords:** state, establishment, borders, sovereignty, nation*

## **HYRJE**

Në studimet politike mësohet se shteti mbetet një ndër njësitë themelore të politikës në arenën ndërkombëtare dhe në mbarë botën, prandaj jo rastësisht shteti është konsideruar ndër konceptet qendrore në studimet e politologjisë si dhe objekt i debatit të vazhdueshëm në traditën shkencore politike. Mirëpo shtetin e studiojnë edhe shkencat tjera siç janë: sociologjia, filozofia, drejtësia (jurisprudenca), gjeografia politike, diplomacia, normalisht që qasje të pjesshme kanë edhe shkencat tjera shoqërore.

Sociologjia, shtetin e sheh si një sistem të pavarur politik administrativ, legjislativ dhe qeverisës i ndërtuar dhe mbajtur në funksion nga popullsia e një hapësire gjeografike sovrane. Sipas filozofisë, shteti, krijohet njëjtë sikurse bashkësitë e para, gjegjësisht ka evolucionin e tij. Prandaj njerëzit për të pasur siguri mbi pronat, lëvizjen e lirë brenda një territori të caktuar dhe rregulla për veprimtari shoqërore janë të detyruar të krijojnë shtete. Autorët e së drejtës ndërkombëtare shtetin e përkufizojnë si institucion të krijuar nga grupi për realizimin e disa qëllimeve, prej të cilëve më i rëndësishmi është ruajtja e së drejtës dhe rendit brenda kufijve dhe ruajtja e pavarësisë së popullit në marrëdhënie me popujt tjerë (svarlien). Gjithashtu edhe gjeografia politike studion shtetin: kufijtë,

mjedisin fizik, rajonet, popullsinë dhe pasuritë natyrore, në krye me udhëheqjen e saj politike. Ndërsa, marrëdhënie diplomatike bilaterale ose multilaterale lidhin vetëm ato shtete të cilat kanë njohur shtetin përkatës.

Çdo shtet ka evolucionin e tij të themelimit, zhvillimit, por disa edhe të zhdukjes së tij. Sot në botë ekzistojnë mbi 206 shtete të pavarura dhe sovrane, por numri i tyre vjen duke u rritur. Në periudha të ndryshme kohore numri i shteteve ka qenë i ndryshëm. Vetëm para Luftë së Parë Botërore numri i shteteve ka qenë më pak se 40, ndërsa sot numri i tyre është pesëfishuar.

Çdo shtet i (i njohur nga shumë shtete tjera apo nga OKB-ja) pavarur është dhe sovran. Mirëpo kemi shtete të pavarura që nuk janë sovrane në kuptimin e plotë të fjalës.

### **1. Themelimi i shtetit**

Shteti është një sistem i pavarur politik, administrativ, legjislativ dhe qeverisës i themeluar dhe mbajtur në funksion nga popullsia e një hapësire gjeografike sovrane. Themelimi i shteteve është rezultat i një procesi historik dhe shoqëror, shumë kompleks, që e kanë themeluar njerëzit. Nga mosnjohja e themelimit të shteteve të para parahistorike, paraqiten vështirësi në të kuptuarit e zanafillës dhe rolit të tij që ka pasur, nga themelimet apo paraqitjet e para të tij e deri më sot. Në literaturën e sotme, sqarimet për themelimin e shtetit, nisen nga nivele teorike që mundësojnë njohjen e tij në të kaluarën. Ndërsa sot, themelimi i shtetit bëhet duke plotësuar disa kushte paraprake dhe përkrahje të shteteve të fuqishme.

Pikëpamjet e para të lidhshmërisë së njeriut me grupin apo bashkësinë njerëzore i paraqet shkenca e filozofisë, bazuar në të dhënat e filozofëve të vjetër grekë. Ndërsa, për popujt apo shtetet që janë që janë zhdukur të dhëna na jep edhe teologjia (islame).

Të dhënat për themelimin e shteteve të para apo që kanë shkruar për mënyrën e organizimit shoqërorë i gjejmë te vepra e Platonit “Shteti”. Ai ka pohuar se “shteti lind për arsye se, secilit prej nesh, nuk na mjafton vetvetja dhe se kërkon shumëçka” (Platoni). Ndërsa Aristoteli shkruan se “Bashkësia komplete është prej shumë fshatarë, e cila, të them kështu, arriti shkallën më të lartë të vetëmjaftueshmërisë që është shteti. Ai themelohet për shkak të mbrojtjes së jetës dhe ekziston për arsye të jetës së lumtur. Prandaj, sipas natyrës, çdo shtet themelohet njëjtë sikurse edhe bashkësitë e para. Sepse, shteti është qëllimi i këtyre

bashkësive, kurse natyra e ndonjë çështjeje paraqet qëllimin e tij” (Aristoteli). Nga këto shqyrtime të filozofëve antikë grekë edhe të tjera që janë të përafërta me ta, del se, njeriu për nga natyra nuk i mjafton vetvetja, pasi ai është *zoom politikom*, pra qenie shoqërore. Nga mendimet e këtyre pikëpamjeve në Greqinë e Vjetër janë krijuar polisët e vjetra. Polis do të thotë qytet-shtet.

Nga filozofët e mëvonshëm do të përmendim Hegelin (gjerman). Ai shtetin e trajton si një tërësi, e cila u paraprijnë pjesëve të veta: familjes dhe shoqërisë qytetare. Hegeli pohonte se shteti është njëmendësia e idesë morale. Ai ka detyrë të vihet mbi kundërthëniet e qytetarëve dhe grupeve të ndryshme shoqërore. Kjo ndikon që qëllimi kryesorë i shtetit të jetë mbrojtja dhe zbatimi i së drejtës e jo i hakmarrjes. Shteti - sipas ligjit - duhet t’i dënojë ata që nuk e respektojnë të drejtën, jo se dëshiron ta dënojë fajtorin, por sepse fajtorit duhet t’i takojë e drejta që të jetë i dënuar (GJ. Rrapi 1997).

Mirëpo, shtetet kanë ekzistuar edhe shumë më herët se sa të dhëna e shkruara nga filozofët e vjetër grekë. Njohuritë shkencore, si astronomike: ndarja e ditës në njëzetekatër orë, javës në shtatë ditë, muaji në 29-31 ditë, viti në dymbëdhjetë muaj; shkalla në 60 minuta, minuta në 60 sekonda e shumë të dhëna tjera i kemi që nga Asiro-Babilonia, tre mijë vjet para Erës së Re (Lindjes së profetit Isa [alejhi selam]). Asiria - Siria e sotme dhe territore rreth saj, Babilonia në Mesopotami, Irakun e sotëm. Pastaj kemi Kinën, Indinë, Persinë, Egjiptin e vjetër - Faraoni (3000 vjet p.e.re.), Mbretëria e Sulejmanit me qendër në Jerusalem (1000 vjet p.e.r.), (H. Jahja 2003) dhe shumë shtete tjera.

Gjatë historisë, me kalimin e kohës filluan të themelohen perandori të ndryshme, për të cilat kemi të dhëna shumë më të qarta, si që janë: Parandoria Ilire, Romake, Bizantine, më vonë Perandoria, Ruse, Otomane, Austro-Hungareze, Prusiane, Angleze, Franceze, Spanjolle etj. Por kemi themelimin edhe të principatave të ndryshme si që janë Principata e Skënderbeut, Rumune, me rënien e Perandorisë Romake krijohen principata të ndryshme.

Me themelimin e principatave të ndryshme, u ndanë shume popuj në disa principata nga ku lindi edhe nevoja e themelimit të shteteve-kombe. Shtetet-kombe filluan të themelohen në Evropën perëndimore pas Konferencës së Vestfalisë të vitit 1648. Në Gadishullin Ballkanik shtetet-kombe filluan të themelohen kah mesi i shek. XIX. Në fillim duke i paguar haraç Perandorisë Otomane dhe disa tjera, pas rënies së kësaj perandorie fituan pavarësi të plotë.

Në jurisprudencë, autorët e së drejtës ndërkombëtare shtetin e përkufizojnë si institucion i themeluar nga grupi, për realizimin e disa qëllimeve, prej të cilave më i rëndësishmi është ruajtja e së drejtës dhe e rendit brenda kufijve dhe ruajtja e pavarësisë së popullit në marrëdhënie me popujt tjerë. Apo si bashkësi, që në një hapësirë të caktuar vepron si një organizatë më e lartë e rendit juridik dhe njëkohësisht nuk është e nënshtruar ndaj asnjë organizate tjetër (Z. Gruda 2003).

Ndërsa, sot, pjesa më e madhe e autorëve, themelimin e shteteve të reja e konsiderojnë si çështje faktike, pasi me plotësimin e disa kushteve, shteti paraqitet si subjekt ndërkombëtar. Për t'u themeluar një shtet duhet t'i plotësojë disa kushte si që janë:

- a) Duhet të ketë popullsi të përhershme;
- b) territor të caktuar;
- c) qeveri;
- ç) aftësi për të hy në marrëdhënie me shtete tjera.

Ndërsa, disa autorë, konsiderojnë që duhet të ketë edhe pushtet sovran mbi territorin.

Sipas konventës së Montevideos, pikat për themelimin e një shteti janë të thjeshta: të kesh një territor, banorë të përhershëm, të ngresh një qeverisje dhe të njihesh nga jashtë - shtete tjera. Por, sado të përcaktuara që janë ato, zonja Robertson thotë themelimi i vendeve - shteteve të reja është i lidhur më shumë me rrethanat historike, mprehtësinë e udhëheqësve dhe vullnetin ndërkombëtar, sesa thjesht me zbatimin pikë për pikë të këtyre rregullave.

Një shtet pasi është themeluar dhe ka vënë themelet e tij udhëheqëse dhe ka nën kontroll të gjithë territorin e tij, ka nevojë edhe për njohje nga shtete tjera, për të pasur bashkëpunim në shumë fusha ndërshtetërore si diplomatike, ekonomike, kulturore dhe fusha tjera.

Sipas të drejtës ndërkombëtare themelimi i shteteve të reja është çështje faktike e jo juridike, prandaj merret si shtet i ri. Me paraqitjen e tij bëhet subjekt i së drejtës ndërkombëtare. Por, çfarë efekti ka njohja: a është njohja konstatim i faktit se një krijesë është shtet, pra subjekt i së drejtës ndërkombëtare, apo shteti bëhet subjekt i së drejtës ndërkombëtare vetëm me njohje. Ka bërë që, të jepen dy teori për njohjen: teoria konstituive dhe teoria deklarative.

a) *Teoria konstituive*, nisat nga qëndrimi se shteti, me faktin se është themeluar, ende nuk është anëtarë i bashkësisë ndërkombëtare (OKB). Shtetet tjera, përkatësisht bashkësia ndërkombëtare, janë ata që do të vendosin se a do ta pranojnë ata shtetin e ri dhe në rrethin e vet apo jo.

Kjo teori është në kundërshtim të d.p.d. me parimin e vetëvendosjes së popujve, pasi shfrytëzimin e të drejtës së vetëvendosjes do ta kushtëzonte me pranimin e shteteve tjera. Në esencë kjo d.t.th mohimin e tij.

b) Sipas *teorisë deklarative*, shteti i ri, automatikisht i fiton të drejtat që i takojnë subjektit ndërkombëtar dhe bëhet anëtar i bashkësisë ndërkombëtare, po qe se i plotëson kushtet që i parasheh e drejta ndërkombëtare. Që d.t.th se shteti nuk themelohet me njohje, por me këtë akt vetë konstatohet se shteti është i themeluar. Kjo teori, është paraqitur më vonë dhe është përkrahur gjerësisht gjatë shek. XX nga shumë autorë dhe praktika diplomatike e ka treguar atë. Këtë të drejtë e përmban rezoluta e Institutit të së Drejtës Ndërkombëtare (1936). Në kohën të cilën jetojmë ne, kjo teori është më e drejtë dhe më shumë i përgjigjet kërkesave të kohës dhe realitetit ndërkombëtar.

Njohja apo mosnjohja e shteteve të reja bëhet për qëllime politike, gjeopolitike dhe gjeostrategjike nga shtetet tjera. Rast më të freskët për njohjen apo mosnjohjen e shtetit më të ri - Kosova - nga shtete të ndryshme, bëhet për interesat e çdo shteti në veçanti, duke pasur parasysh, historinë e saj, popullsinë, pozitën gjeografike dhe gjeostrategjike të saj, por edhe për uljen e tensioneve në regjion dhe jo rastësisht zonja Robertson thotë se njohja ndërkombëtare është një nga synimet më të vështira për t'u arritur dhe shpesh merr më shumë rëndësi se sa vetëvendosja. Ja ç'thotë ajo për rastin e Kosovës. "Nga njëra anë Kosova po e tregon shumë qartë dëshirën e saj për vetëvendosje dhe po i thuhet 'jo'. Nga ana tjetër kemi Timorin Lindor, që e bëri deklaratën e pavarësisë dhe menjëherë trupat paqeruajtëse atje e ndihmuan. Bëhet fjalë për standarde të dyfishta", tha ajo. Ajo shtoi, se, faktori i fundit i rëndësishëm për themelimin e një shteti, është veprimi i shpejtë dhe energjik. Sipas saj udhëheqësit që marrin vendime konkrete drejt pavarësisë, e kanë më shumë në dorë fatin e vendit, sesa ata që vetëm presin (<http://VOA>. si krijohet një shtet i ri 2003).

Sido që të jetë, njohja dhe shpallja e pavarësisë së shtetit është moment i rëndësishëm në jetën e çdo shteti. Megjithëse njohja është akt i lirë i çdo shteti, ajo vjen pasi të jenë matur interesat e shtetit që pranon. Nga kjo del se njohja në praktikë është më tepër çështje politike se sa e së drejtës. Kur një shtet njeh pavarësinë e shtetit të ri, atëherë shtohen mundësitë që shteti i cili e ka pasur nën okupim territorin dhe që i është ndarë, t'i prish marrëdhëniet diplomatike me shtetet që e njohin shtetin e ri. Raste të tilla ka pasur edhe më parë, por, rast më të ri kemi me

Sërbinë, që i prishi marrëdhëniet e saj diplomatike apo thënë ndryshe i tërhoqi disa ambasador të saj nga vendet që e njohën pavarësinë e Kosovës, në shenjë revolte, por më pas disa i ktheu përsëri.

Si në ish-BRSS ashtu edhe në ish-Jugosllavi, të drejtat e popujve për vetëvendosje u garantohej me ligj. Por në praktikë ndodhte e kundërta, asnjë shtet dhe asnjë popull nga këto dy ish-shtete nuk mundi ta realizojë të drejtën e saj për vetëvendosje edhe pse në të parën kishte shtete që ishin të njohura ndërkombëtarisht, por në praktikë ishin nën diktat të Ruisë, gjegjësisht të varura. Ndërsa në të dytën nuk kishte shtete të pavarura. Por, deri te arritja e pavarësisë së tyre, u bënë luftëra shkatërrimtare si në Kroaci, Bosnje dhe së fundmi në Kosovë.

Shtetet kombëtare, pavarësi dhe njohje ndërkombëtare kanë fituar në periudha të ndryshme kohore. Kryesisht prej fundit të shek. XVIII e këndej (përjashtim bëjnë shtetet që kanë pasur koloni). Nëse shihet me kujdes harta e botës, në periudha të caktuara, shumë shtete të një rajoni të caktuar kanë fituar pavarësi për periudhë të afërt njëri nga tjetri. Ka fundi i shek. XVIII dhe gjatë shek. XIX pavarësi kanë fituar pjesa dërmuese e shteteve në kontinentin amerikan. Pas Luftës së Parë Botërore, pavarësi fitojnë kryesisht disa shtete në Evropë dhe disa shtete në Azinë Jugperëndimore. Pas, Luftës së Dytë Botërore, pavarësi fitojnë kryesisht shtetet afrikane dhe shtetet e Azisë Juglindore, Jugore dhe disa shtete në pjesën jugperëndimore. Ndërsa pavarësi pas rënies së komunizmit fitojnë shtetet e dala nga ish-Jugosllavia, Evropa Lindore si Ukraina dhe Bjellorusia si dhe shtetet e Azisë Qendrore.

Nga ana tjetër kemi shtete dhe popuj të cilët janë zhdukur, por kemi edhe popuj të cilët edhe sot e kësaj dite ekzistojnë por nuk kanë arritur që të kenë shtete nacionale, apo të paktën shtet i cili njihet me emrin e kombit.

Shtete të zhdukura kemi plot, që prej kohërave të lashta e deri më sot, thënë ndryshe në historinë bashkëkohore. Duke filluar prej Mesopotamisë së hershme, Egjiptit me në krye Faraonin etj., por edhe më herët. Pastaj kemi Perandorinë Romake, Ilire, Perse, më vonë atë Bizantine. Gjatë Mesjetës, e deri në përfundim të Luftës së Parë Botërore kemi perandoritë Angleze, Spanjolle, Portugeze, Austro-Hungareze, Prusiane, Ruse, Turke etj.. Tanimë perandori “nuk ekzistojnë”, dhe prej këtyre perandorive janë themeluar shtete kombëtare, kuptohet me kufi të ndryshueshëm.

Shtete të cilat janë krijuar kemi plot. Ndërsa, shtete që janë zhdukur, në kohën më të re kemi shumë pak. Por, në të kaluarën ka pasur

shumë, pasi çdo shtet i okupuar nga ndonjë perandori apo shtet tjetër është zhdukur. Raste të tilla kemi në kohën më të re siç janë: Ish-Jugosllavia, prej sajë janë themeluar shtete si: Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia e Veriut; Çekosllovakia, nga e cila u themeluan Çekia dhe Sllovakia: Pastaj kemi shtete të cilëve u janë shkëputur disa pjesë të sajë por shteti vazhdon të ekzistojë, por me kufij më të cinguar, si që është Rusia, nga kjo u themeluan shtetet e Azisë Qendrore, Evropës Lindore. Prej Indonezisë u themelua Timori Lindor.

Popuj të zhdukur kemi plot, kryesisht në të kaluarën, në Gadishullin Arabik si që janë: populli i Adit, Lutit, Ibrahimit, grekët e vjetër, Thrakasit etj. Por janë krijuar popuj të rinj, që sot kemi mjaft që nuk ka nevojë që t'i përmendim sepse janë shumë. Nga ana tjetër kemi popuj që akoma nuk kanë mundur të krijojnë shtete më vite. Raste të tilla kemi plot edhe sot siç janë: kurdët, çeçenët, tatarët, tibetasët, baskët dhe shumë popuj tjerë që gjenden në shtete të ndryshme kryesisht në shtete të mëdha si në Rusi, Kinë, Indi, Indonezi, Spanjë, Iran, etj.

## 2. Kufijtë e shtetit

Kufijtë shtetërorë, përkufizohen si vija ndarëse, që ndajnë territorin e një shteti nga territori i shtetit apo shteteve fqinje, territorin e një shteti dhe detit të hapur, si dhe vija deri ku shtrihet territori dhe Sovraniteti i një shteti. Megjithëse, territori i shtetit është tredimensional, përveç sipërfaqes tokësore dhe ujore në të bëjnë pjesë edhe dheu nën të (prej kufirit në drejtim të qendrës së tokës) si dhe lartësia mbi sipërfaqen e tij gjegjësisht hapësirën ajrore (në drejtim vertikal drejt universit).

Kufijtë e shteteve, gjatë gjithë historisë, shpeshherë kanë ndryshuar. Ndryshimet e tyre kanë ndodhur, kryesisht me okupimet e territoreve, tërheqjes nga okupimi, si pasojë e luftërave. Zhan Zhak Rusoi shkruante: “Aty ku vihet litari dhe thuhet se kjo është e imja fillon lufta”. Këtë më tepër e vërteton T. Holdish i cili shkruan: “Është e tepërt të përsëritet që në këtë botë njerëzore të ambicieve dhe të tokës së uritur, kufijtë e shteteve nuk piketohen, me qëllim për të asimiluar popujt e njërit ose tjetrit vend”. Ndërsa sot strategjia politike ka ndryshuar. Kohëve të fundi këto dy dekada janë ndryshuar shumë kufij për qëllime si: politike, ekonomike, kombëtare, kulturore, fetare dhe qëllime tjera. Kur themi themelim të shteteve të reja për qëllime politike, kemi parasysh që, shtetet e mëdha dhe të fuqishme, dëshirojnë të mbeten të



tilla. Prandaj themelimi i shteteve të vogla u konvenon atyre, pasi shumë më lehtë mund t'i kenë nën kontroll dhe të ndikojnë mbi ta, në të gjitha aspektet si politike, ekonomike, shoqërore, por në raste të veçanta edhe fetare. Varësisht cili shtet nën ndikimin e cilit shtet është.

Koncepti për kufirin, me kalimin e kohës ka ndryshuar. Por, edhe ka evoluar. Sot, ka ardhur deri në atë masë që, çdo pikë e kufirit të dihet me përpikëri. Kuptimet pararendëse për kufirin e shtetit janë:

- a) *Kufiri antik;*
- b) *Kufiri në periudhat perandorake të antikitetit;*
- c) *Kufiri në Mesjetë;*
- ç) *Kufijtë e shtetit kombëtar;*
- d) *Kufijtë arbitrar dhe*

e) *Kufiri modern.* Kufiri modern, në pjesën më të madhe të rasteve është një vijë e përcaktuar mirë përgjatë të cilit ruhen dy sovranitete.

Në përcaktimin e kufijve, ndikojnë faktorët historikë, gjeografikë, ekonomikë, strategjikë, etnikë, qoftë të kombinuar ose veçmas. Por, në botë kemi edhe mjaft kufij arbitrarë (në të shumtën e rasteve ata që i kanë përcaktuar kufijtë as që kanë pasur njohuri më elementare për vendet dhe popujt e caktuar, kryesisht në Afrikë).

Në kufijtë ujorë teorikisht apo ligjërish, sovraniteti i një shteti mbaron në kufirin e ujërave të tij territorial, por ai gjithmonë pretendon të ketë sovranitet të plotë më në thellësinë e detit të hapur. Edhe pse ujërat detarë paraqesin një tërësi fizike, ata kanë status të ndryshëm juridik. Ndahen në ujëra bregdetarë dhe ujëra (dete) të lirë. Ujërat bregdetarë, më tutje ndahen në:

1. *Ujërat e brendshëm detarë dhe*
2. *Ujërat territorialë.*

*Ujërat bregdetarë* shtrihen midis hapësirës tokësore të një shteti dhe detit të lirë dhe janë pjesë e territorit shtetëror me regjim më specifik se sa regjimi i hapësirës tokësore dhe detit të lire edhe pse janë nën juridiksionin e shtetit përkatës anësor dhe sovranitetin e tij.

*Ujërat e brendshëm detarë*, përfshijnë ujërat e limaneve, gjireve, ngushticave, ujërat brenda arkipelagëve, detet e brendshme, hapësirën ndërmjet vijës më të lartë të baticës dhe vijës më të ulët të zbatës dhe deltat e lumenjve.

*Ujërat territorialë*, përfaqësojnë një pjesë të detit që shtrihet paralelisht me vijën bregdetare në lagësi të caktuar. Gjatë historisë ka pasur propozime të ndryshme për kufirin e ujërave territoriale si p.sh. në, shek. XIV deri në 100 milje. Gjerësinë e ujërave territoriale e

përcaktojnë vetë shtetet, duke u mbështetur në faktorët gjeografikë, strategjikë dhe ekonomikë. Ndërsa në teori shumica e shteteve janë deklaruar për gjerësinë prej 3-12 milje. Mirëpo ka pasur shtete që nuk janë pajtuar edhe me këtë dhe një numër i madh i shteteve i ka zgjeruar ujërat e veta territoriale prej 20-200 milje (Angola 200 milje, Senegali 150 milje etj.)

E drejta ndërkombëtare, deri vonë, nuk ka pasur qëndrim të prerë për këtë, megjithatë e ka përcaktuar gjerësinë e këtyre ujërave në mënyrë të tërthortë. Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit i ka dhënë fund njëres nga çështjet më kontestuese të së drejtës së detit, duke paraparë shprehimisht se çdo shtet ka të drejtën të caktojë gjerësinë e ujërave të veta territoriale deri në 12 milje, duke filluar nga vija fillestare (neni 3) e jashtme të ujërave të brendshëm (Z. Gruda, 2003). Por, ka shtete të cilat janë përcaktuar për gjerësi të ndryshme nga ajo e përgjithshmja. Ka shtete të cilëve nuk u pëlqen edhe largësia 3 miljesh e të mos flasim për atë 12 miljesh (SHBA). Pasi që SHBA-të kontrollojnë detin e hapur dhe dëshirojnë të jenë më afër bregdetit të çdo shteti, për ta pasur nën kontroll atë dhe nga ana tjetër anijet që lundrojnë në detin e hapur u paguajnë taksa atyre për lundrim të sigurt.

Kur dy shtete (përfshirë këtu edhe ishujt) qëndrojnë kundruall njëri-tjetrit, kufiri midis tyre shtrihet përgjatë vijës e cila është në largësi të barabartë nga vija fillestare nga të dy anët. Mirëpo ka edhe raste specifike që janë rregulluar me marrëveshje ndërkombëtare, ose nga rregullat ndërkombëtare dhe janë ende të papërcaktuara. Rast të tillë kishim përcaktimin e kufirit ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë me ishullin Korfuz, se prej ku duhej filluar vija fillestare. Ende i papërcaktuar.

*Ujërat e lira apo deti i hapur.* Hapësirat e gjëra detare dhe oqeanike, të cilat shtrihen jashtë kufirit të ujërave territoriale, përfaqësojnë detin e hapur ose detin e lirë. Në këto hapësira, deti është i hapur për të gjitha shtetet apo popujt dhe asnjë shtet, legalisht, nuk mund të pretendojë që të vendosë nën sovranitetin e vet ndonjë pjesë të saj. Deti i hapur, ka statusin e lirë, mbi të cilin vlen rregulla e lirisë së detit. Liritë në të janë:

- a) Liria e lundrimit të anijeve tregtare dhe ushtarake apo të luftës;
- b) Liria e peshkimit;
- c) Liria e vënies së kabllave nëndetare dhe
- ç) Liria e fluturimit të aeroplanëve mbi detin e hapur. Por, ekziston edhe liria e kërkimeve shkencore.

Për lundrim, në detin e hapur, është e nevojshme apo mos thënë e detyrueshme që anija të jetë e regjistruar, të ketë leje për lundrim dhe të

ketë flamurin e një shteti. Anijet tregtare, por edhe ato luftarake bashkë me personelin dhe të mirat material që janë në të, gjatë lundrimit nëpër detin e hapur, janë nën juridiksionin e shtetit, flamurin e të cilit e mban anija. Anija pa flamur nuk gëzon të drejtën e mbrojtjes ndërkombëtare, por edhe ajo anije që ka dy flamuj, llogaritet sikur nuk ka asnjë. Të tillat, anijet luftarake të cilitdo shtet qofshin, kanë të drejtë ta ndalin, të bëjnë kontroll por e kanë edhe të drejtën e konfiskimit të saj. Kjo është e detyrueshme pasi anijet pa flamur nuk dihet se nën juridiksionin e kujt janë dhe mund të bëhen keqpërdorime për kontrabandë dhe pirateri të ndryshme dhe të mos dihet se kush kundër kujt është dhe kush me kë është.

Në detin e hapur kemi plot anije jo legale dhe pirate, me përkrahje të fshehta ose kokë më vete të grupeve disidente. Edhe pse deti, ditët e sotme mund të kontrollohet nga satelitët çdo sipërfaqe e tij në çdo kohë. Por gjërat e tilla shpeshherë kanë përkrahje nga organizata apo grupe të ndryshme.

### 3. Sovraniteti

Sovraniteti është drejta e ekskluzive për të ushtruar autoritetet suprem mbi një grup njerëzish në një rajon gjeografik. Në të drejtën ndërkombëtare, koncepti më i rëndësishëm i sovranitetit i referohet ushtrimit të autoritetit nga shteti në tërë territorin shtetëror duke përfshirë sipërfaqet tokësore dhe ujore brenda kufijve, toka dhe ujërat nën këtë sipërfaqe dhe ajri mbi të.

Kufijtë ndërmjet shteteve ndajnë territorin fizik - tokësor nga shteti që kufizohet dhe në hapësirat detare, ndanë kufirin ndërmjet ujërave shtetërore dhe detit të hapur. Mbi të gjitha kufijtë ndajnë sovranitetin e një shteti nga ajo e fqinjëve të tij dhe detit të hapur. Që do të thotë se: asnjë shtet, përtej kufijve administrativ të tij nuk ka të drejtë të mbledh taksa, të urdhërojë regrutim të popullsisë në raste lufte, ose të marrë në shërbim ushtarak në kohë paqe, të miratojë ligje, të pushtojë një shtet apo territor të ndonjë shteti tjetër. Përveç në raste të veçanta, nëse i janë dhënë nga ndonjë traktat ndërkombëtar ose i janë garantuar nga ligje ndërkombëtare. Rast të tillë kemi me Kinën kundrejt Tajvanit.

Përderisa shteti ka sovranitetin e tij, ai ka të drejtën absolute që të mos i lejojë aeroplanët e shteteve tjera që të fluturojnë mbi hapësirat e tij. Rast të tillë patëm para disa viteve, kur Greqia nuk e lejoi aeroplanin e Maqedonisë me mbishkrimin MAT që të hyjë në territorin e saj, ndërsa Kryetari i Maqedonisë u detyrua të udhëtojë me aeroplan të huaj. Fluturimi

i aeroplanëve mbi territore të shteteve tjera, bëhet me marrëveshje. Për satelitët, ende nuk ka ndonjë marrëveshje ndërkombëtare edhe pse satelitët rrotullohen pa ndërprerë në orbitën e Tokës. Qytetarët e një shteti, nuk kanë të drejtë të hyjnë në shtete tjera pa leje - viza, por shpesh ndodh që edhe kur i posedojnë ato nuk lejohen të hyjnë. Ndërsa sovraniteti në hapësirat ujore shtetërore është diç më i cunguar. Anijet e shteteve të huaja lejohen të kalojnë nëpër ujërat e shteteve bregdetare vetëm nëse nuk paraqesin rrezik apo dëm për shtetin që ujërat janë nën sovranitetin e tij.

OKB është organizata më e madhe në botë e cila për qëllim ka sigurinë ndërkombëtare, zhvillimin ekonomik dhe barazinë sociale. Ajo u formua në vitin 1945 me iniciativën e shteteve fituese të Luftës së Dytë Botërore. Ajo është themeluar me qëllim të forcimit të bashkëpunimit midis shteteve të botës, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së paqes në botë. Parimet kryesore të sajë janë:

1. Barazia sovrane (edhe për shtetet që nuk janë anëtare);
2. Zgjedhja paqësore e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare;
3. Ndalimi i përdorimit të forcës ose i kërcënimit me forcë;
4. Ndalimi i ndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve tjera.

E gjithë rrjedh kjo nga e drejta e lirive të njeriut dhe e drejta për vetëvendosje të popujve. Fatkeqësisht, që këto të drejta në masë të madhe nuk janë respektuar në pjesën më të madhe të botës, në shtete të ndryshme dhe te popujt e ndryshëm.

Kur kemi parasysh se, sovraniteti është drejta e ekskluzive për të ushtruar autoritet suprem mbi një grup njerëzish në një rajon gjeografik, kjo bie ndesh me të drejtat e njeriut pasi në grupe të caktuar është e pamundur që të gjithë njerëzit të jenë të një mendjeje. Ndërsa, kur kemi parasysh të drejtën ndërkombëtare, koncepti më i rëndësishëm i sovranitetit i referohet ushtrimit të autoritetit nga shteti, në tërë territorin shtetëror. Këtu hasen probleme me pakicat kombëtare, në ato vende ku nuk i gëzojnë të drejtat minimale si grup i ndryshëm shoqëror nga shumica e shtetit përkatës. Atëherë fillojnë problemet shtetërore, që në shkencë quhen forca centrifugale. Pasi, nëse në një shtet, nuk kemi respektim të të drejtave të grupeve të ndryshme, atëherë grupi i caktuar fillon të organizohet nga anëtarët e saj. Që do të thotë fillon organizimin separatist ose irredentist, gjegjësisht shteti e humb pjesërisht kontrollin mbi këta grupe që përkon edhe me humbjen e sovranitetit në pjesë të caktuar të territorit të vet.

Nga ana tjetër, kemi shtete të cilat *de jure* në botë njihen si shtete të pavarura dhe sovrane, mirëpo, në realitet apo *de facto* nuk janë të

tilla, siç është Afganistani, por edhe Iraku. Këta shtete janë të pranuar edhe në OKB, si shtete sovranë dhe të pavarura. Mirëpo, në praktikë nuk janë të tilla pasi janë të pushtuara nga forcat e NATO-s. Edhe në njërin edhe në tjetrin shtet, forcat e sigurimit të tyre, zona të caktuara nuk i kanë nën kontroll, por as forcat e NATO-s e as forcat e armatosura dhe policia e këtyre shteteve, që do të thotë se nuk kanë as sovranitet të plotë mbi gjithë territorin e tyre por nuk kanë as pavarësi në funksionimin e tyre si shtet.

Bosnja dhe Hercegovina është në situatë edhe më të mjerë. Pasi është i vetmi shtet në botë, që brenda shtetit zhvillohen dy mënyra të organizimit juridik shtetëror edhe atë federatë dhe konfederatë. Konfederata Kroato-Bosnjake dhe Republika Sërpska përbëjnë shtetin federativ të Bosnjë dhe Hercegovinës. Sistemi i tillë sigurisht që është bërë për qëllime politike, në Konferencën e Dejtonit më 1995. Rast edhe më të pa kuptimtë kemi në Kosovë. Kosova ka shpallur pavarësinë e saj dhe është njohur nga rreth 120 vende të ndryshme të botës. Shpesh nga politikanët e Kosovës, por edhe nga diplomat të huaj (që e kanë pranuar pavarësinë e saj) përmendin Kosovën si shtet i pavarur dhe sovran. Po vallë në realitet a është i tillë? Për sovranitet është e palogjikshme të flitet. Pasi me ndarjen territoriale të saj, janë krijuar disa enklava serbe, në të cilat pushteti i Kosovës absolutisht nuk i kontrollon ata dhe kryesisht pjesën veriore të saj, për të cilën thuhet se, administrohet nga organet ndërkombëtare UNMIK dhe EULEX. Por, në realitet janë nën ndikimin serb nga Serbia. Pastaj në Nenin 143 të kushtetutës së R. së Kosovës (sipas planit të Ahtisarit) thuhet që Piter Feit (i dërguari special nga OKB) ka të drejtë të shkarkojë dhe të emërojë kryetarin, kryeministrin dhe cilindo ministër në Kosovë. Nga ana tjetër në Kosovë ende nuk është e qartë se kush udhëheq, UNMIKU, EULEXI apo Qeveria e Kosovës, shikuar nga neni i lartpërmendur. Ndërsa, kufijtë e saj i ruan KFOR-i, rendin publik e ruan policia e Kosovës në “bashkëpunim” me policinë e EULEX-it dhe në pjesën veriore edhe policinë e UNMIK-ut. Disa qeveri në “një shtet të pavarur dhe sovran”?!

#### **4. Përfundim**

Me ndryshimet politike në aspektin global, ndryshojnë edhe rrethanat, si në rajone të ndryshme të botës ashtu edhe brenda shteteve në përgjithësi. Ndryshojnë sistemet politike dhe ekonomike, këta kanë ndikimin e tyre edhe në kulturë, në të drejtat a pakicave, të drejtat e

njeriut. Por, ndikimet janë të mëdha prej njërit shtet nga tjetri, prej njërit në shtetin tjetër. E gjithë kjo varet nga shumë faktorë si: pozicioni gjeografik, gjeopolitik, kultura e një populli - shteti, feja, por edhe pasuritë natyrore që i ka një shtet. Pasi e tërë politika në botë (nga fuqitë e mëdha) bëhet, se kush në cilin territor me pasuri natyrore (si naftë, minerale) do të ketë ndikim e saj më të madh.

Duke pasur parasysh atë që thamë më lartë, kuptohet që për të pasur ndikimin e tyre, shtetet e fuqishme mundësojnë edhe themelimin e shteteve të reja. Me themelimin e shteteve të reja, dobësohet një shtet që është deri diku i fuqishëm. Kur themelohen shtete të reja, kuptohet që ndryshojnë edhe kufijtë si të shtetit paraprak ashtu edhe të shtetit të ri. Mirëpo, a përcaktohen kufijtë e shteteve të reja ashtu siç duhet të jenë? Sigurisht se jo. Pasi ata përcaktohen në baza historike, sipas kufijve që kanë ekzistuar në konstituimin paraprak të atij shteti që ka qenë më parë, sigurisht duke pasur parasysh dhe shumë faktorë tjerë.

Ndërsa, kur kemi parasysh sovranitetin e një shteti, sot është shumë vështirë të thuhet se një shtet ka sovranitetin e plotë në kuptim të fjalës, përveç shteteve të fuqishme. Disa shtete, kur bëhen anëtare të ndonjë organizate qeveritare, pjesërisht e humbin sovranitetin e tyre. p.sh nëse një shtet bëhet anëtare e Bashkimit Evropian, pjesërisht e humb sovranitetin, pasi, për t'u marrë një vendim në PE duhet që të votohet në mënyrë unanime, që d.t.th. se shtetet duhet lëshuar pe për çështje më të mëdha se sa interesi kombëtar. Nga ana tjetër nëse bëhesh anëtare e NATO-s, përsëri një pjesë të sovranitetit e humb. Pasi sipas konventës së saj, nëse një shtet anëtare e NATO-s sulmohet nga një shtet jo anëtare, atëherë të gjithë shtetet anëtare janë të detyruar që të luftojnë së bashku edhe nëse nuk i konvenon ndonjërit nga anëtarët për arsye të ndryshme.

Nga ana tjetër, nëse shteti anëtarësohet në organizata tjera, nuk do të thotë se e ka humbur sovranitetin, qoftë në organizata ndërkombëtare si OKB, OBSH, UNHCR etj., qoftë në ato regjionale si IEQ, IBEDZ etj. Anëtarësimi në organizata të tilla e ruan sovranitetin e plotë të çdo shteti

Si në të kaluarën, në të tashmen, por edhe në të ardhmen do të kemi ndryshime të politikave globale, ndryshime të kufijve, themelime të shteteve të reja, bashkime të shteteve të ndryshme dhe të organizatave të ndryshme, që do të thotë se bota është çdoherë në lëvizje si në politikë, ekonomi, kulturë, etj., që vijnë sipas nevojave të kohës.

## Conclusion

In global terms with the political changes, the circumstances change as well, in various regions of the world and different states in general. The political and economical systems alter; they also have an impact on culture, minority and human rights. But the effects are great from one country to another. This depends on many factors: the geographic and geopolitical location, the culture of a people-state, religion, as well as the natural resources of a particular state. Since, all the policies conducted in the world (starting from the great powers), who in which territory with the natural resources (oil, minerals) will have its greater impact.

Bearing in mind what we previously said, it is understood that in order to have their influence, the powerful states allow the establishment of new states. With the establishment of new states, a somewhat powerful state gets weakened. It is understood that by establishing new states the borders change as well, as the ones of the anticipatory state so do the ones of the new state. However, are the borders of a new state defined as they should? Of course they are not. They are determined on historical basis, according to the existing borders of the prior constituted state, surely considering many other factors.

Whereas, when considering the sovereignty of a state, today it is very difficult to say that a state has a full sovereignty in every sense of the word, besides the powerful states. Some states, when becoming members of different organizations they partially lose their sovereignty, for instance, if a state becomes a member of the European Union, it partially loses its sovereignty. In order for a decision to be brought by the European Parliament, unanimous voting is necessary, i.e. for issues greater than the national interest, states need to have tolerance. On the other hand, even if a state becomes a member of NATO, it loses. Since, according to its convention, if a state being a member of NATO gets attacked by a nonmember state, all the member states must fight back together even if it is not convenient to some of them for various reasons.

On the other hand, if a state joins other organizations, it does not mean that it has lost its sovereignty, whether in international like the UN, WHO, UNHCR, etc., or the regional ones like CEI, IBEDZ etc. The membership in such organizations retains full sovereignty of any state.

As in the past, in the present but in the future as well, we will have global policy changes, border changes, establishment of new states, unions of different states and organizations, which means that the world is continuously in motion as in politics, economy, culture, etc. which needs change through time.

**Literatura:**

1. Aristoteli, "Politika", Tiranë, Plejad, 2003.
2. Ferati, Haxhi, "Gjeopolitika dhe gjeostrategjia" (1), Pena, Prizren, 2019
3. Friedman, George, "100 vitet e ardhshme" Plejada, 2010.
4. Goldstein, Joshua, "Marrëdhëniet ndërkombëtare", Dituria, 2003.
5. Gruda, Zejnullah, "E drejta ndërkombëtare publike" UP, Prishtinë, 2003.
6. Huntington, Samuel, "Përplasja e qytetërimeve", Logos-a, 2004.
7. Jahja, Harun, "Popujt e zhdukur", 2003.
8. Rrapi, Gjergj, "Sociologjia" instituti i soc-filoz, Prishtinë, 1997.
9. Yzeiri, Eqerem, "Gjeografia politike", shblu, Tiranë, 2005.
10. Малески, Денко, "Меѓународна политика", Скопје, 2000.
11. Први, Том, "Народопсихологија и глобализација", универзитетско издателство, Велико Трново, 2005.
12. (<http://VOA.si> krijohet një shtet i ri 2003).